



Bazuar në Nenin 47, paragrafin 10 të Ligjit Nr. 08/L – 197 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe Vendimin me numër A.nr. 813/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e më poshtëm KPMSHCK) të datës 08.08.2024, pranuar në AKP me datë 02.09.2024 me Nr. Protokolli 3584, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datë 05 Shtator 2024, publikon këtë:

NJOFTIM PËR ANULIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 04 Prill 2024, ka shpallur konkurs për pozitën Zyrtar për Kadastër, Klasa Profesional 2 me Nr. Ref: RN00013744.

Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare, kandidati, i pakënaqur me procesin e rekrutimit nr. ref: RN00013744, ka parashtruar ankesë në KPMSHCK.

KPMSHCK, me Vendimin A.nr. 813/2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi dhe obligon Divizionin e Burimeve Njerëzore pranë AKP-së të "Anuloj Konkursin me nr. ref. RN00013744" si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit njofton për anulimin e procedurës së rekrutimit me nr. ref. RN00013744.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë anekese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Prishtinë, 05 Shtator 2024

Fatos Meqa

Udhëheqës i Burimeve Njerëzore

Agjencia Kosovare e Privatizimit